REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

NR:008/2019 Nr.prot:47/19 Lenda nr.62419024521

Për:	N.N.P. "AS-ING", Sopijë-Suharekë, SOPIJË NR.Fiskal 600731344
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar Komuna Suharekë
Nga:	Bujar Kuçi, shef i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	**VENDIM** për kërkesat për rishqyrtim të datës:07/06/2019 te dorezuar nga OE .N.P. "AS-ING",
Datë:	**07/06/2019**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 07.06.2019 të parashtruar nga Operatoret Ekonomik N.N.P. "AS-ING", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi dhe meremetimi i shkollave në Komunë 2 Lot pjesë"** me Nr. të Prok: **624-19-2036-5-2-1 & 624-019-024-521**, nxjerr:

V E N D I M

1. ***Refuzohet*** kërkesat për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik ne grup: N.N.P. "AS-ING", e datës: 07.06.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi dhe meremetimi i shkollave në Komunë 2 Lot pjesë"** me Nr. të Prok: **624-19-2036-5-2-1 & 624-019-024-521**, kundër Njoftim per Vendimin e AK –së, të datës 31.05.2019 te publikuar ne platformen elektronike. Kerkesa per rishqyrtim eshte dorezuar pas afatit per ankesa.

2. ***Vërtetohet*** **NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 31.05.2019;**

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : https://e-prokurimi.rks-gov.net.

Arsyetim

AK Komuna Suharekë, ka vendosur në platformën elektronike Vendimin e AK me datë 31.05.2019 në ora 13:55:57, OE NNP AS ING, ka kërkuar qasje dhe e njëjta i është ofruar brenda ditës së kërkuar.
Afati për dorëzimin e kërkesës për rishqyrtim ka qenë:
31.05.2019 Data e publikimit të vendimit (ditë e premte dita zero)
01.06.2019 Dita e parë
02.06.2019 Dita e dytë
03.06.2019 Dita e tretë
04.06.2019 Dita e katërt
05.06.2019 Dita e pestë (Dita kur eshtë informuar se kërkesa duhet të behet përmes platformes dhe ku ka deklaruar se e ka dorëzuar ne e-prokurim)
06.06.2019 Dita e gjashtë (Eshte kontaktuar përmes telefonit nga AK dhe është njoftuar se AK nuk ka pranuar asnje dokument apo kërkese nga OE. Ne kete datë pas orarit te punës ka derguare një SCREEN/foto (duke menduar se e ka derguar kerkesen) ku shihet se kërkesa për rishqyrtim nuk eshte dërguar por është në "PËRGADITJE".
07.06.2019 Dita e shtatë, Ora: 8.28, AK ka kërkuar sqarim nga KRPP dhe kemi marr përgjigje se OE nuk ka dorëzuar sepse statusi i kërkesës është në "PERGADITJE". Eshte informuar me email se kjo është përgjigja e KRPP-së, ju ende nuk keni dorëzuar kërkesë për rishqyrtim. Pas kësaj OE ka dërguar me platform kërkesën për rishqyrtim siq mundë ta shihni në SCREEN/foto më poshtë në datën 07.06.2019 ora 11.01.00. Nga kjo AK ju informon se OE ka dorëzuar kërken për rishqyrtim pas afatit të përcaktuar me LPP dhe me RRUOPP dhe rregullave për Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave

DATA DHE ORA KUR OE ESHTE INFORMUAR PER VENDIMIN E AK:



DATA DHE ORA KUR OE KA DOREZUAR KERKESEN PER RISHQYRTIM:



DATA DHE ORA KUR OE KERKESEN PER RISHQYRTIM E KA NE PERGADITJE (dokument i derguar nga OE):



Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.
Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit